



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:272378
Datë: 26.01.2024
Numri i dokumentit: 05247712

A.nr.1657/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu dhe bashkëpunëtoren profesionale Erbleta Shala, në konfliktin administrativ të paditëses J.. B.. nga K..., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson E..P., avokat nga V.., kundër të paditurës së parë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës dhe të paditurës së dytë Komuna e Klllokotit, për shkak të anulimit të vendimit Nr.297/2019 të datës 21.05.2019 të të paditurës së parë, pas shqyrtimit kryesor publik, me datë 25.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditëses J.. B.. nga K..., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson E..P.. avokat nga V..

II. ANULOHET vendimi Nr.297/2019 i datës 21.05.2019 si dhe Vendimi i shkallës së parë Nr.02/c-110 i datës 05.04.2019 i të paditurës së parë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës.

III. Ky Aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, u mbajt konform nenit 41 të LKA-së, me praninë e palës paditëse e në mungesë të palëve të paditura të ftuara në mënyrë të rregullt.

Paditësja përmes padisë së datës 15.07.2019, ka kërkuar anulimin e vendimit të kontestuar me padi. Shton se vendimi i ankimuar i organit të paditur është i paligjshëm në çka ky organ përkundër të gjitha provave të nxjerrura padyshim gabimisht ka vërtetuar dhe kundërligjshëm ka vendosur që

ankesa ime nuk mund të pranohet. Shton se vendimi është juridikisht i paqartë dhe bie ndesh me vetveten dhe arsyetimin e tij në të cilin nuk janë dhënë arsyet mbi faktet vendimtare gjë që ka sjellë në miratimin e vendimit të atakuar. I propozon Gjykatës që ta aprovoj padinë e paditësit ta aprovoj si të bazuar.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i paditëses deklaroi: *“Mbesim pranë padisë, kërkoj nga gjykata aprovimin e padisë, të prish vendimin nr.297/2019 i dt.21.05.2019, tllë MPMS-së, -I.P., dhe lëndën ta kthej në rivendosje tek e paditura I.P., ose aktvendimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës të paditëses në vendin e punës motër medicinale dhe vendimin nr.1467/2 dt.21.05.2018, te konsideron si të kundërligjshme dhe të detyroi të paditurën Komun as e Klllokotit paditësen ta kthej në punë në ambulanten në fshatin Vërbovc me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës duke përfshirë edhe pagesën e të ardhurave personale si dhe t’ia kompensoi shpenzimet e procedurës. Komuna e Klllokotit me aktvendimin e saj mbi ndërprerjen e marrëdhënien e punës për paditësen nuk e ka respektuar nenin 76 të Ligjit të Punës, ka bërë ndërprerjen e marrëdhënies së punës pa respektuar asnjë procedurë ashtu siç parashihet me ligj. Pas largimit të paditëses nga puna Komuna ka shpall konkurs të ri për vendin e punës të punëtorëve të larguar në mënyrë kolektive duke mos respektuar të drejtën e tyre që sëpari punëtorëve të larguar t’iu ofroj vend të punës e pastaj nëse njëri nga ty mos të pranoj atëherë të bëj zgjedhje të reja, andaj edhe këtu ka bërë shkeljen ligjit më lartë të cituar. Kërkoj nga gjykata të shqyrtoj aktin administrativ të sulmuar me padi në pajtim me nenin 35 të LKA-së si dhe nenin 44.2 të LKA-së. Konsideroj se akti administrativ është jo ligjor, në kundërshtim me rregullat, formën ose elementet obligative të aktit administrativ, në kundërshtim me ligjin materiale dhe është rezultat i diskrecionit që është aplikuar jo ligjërisht. Konsideroj se e paditura e parë në këtë rast ka tejkaluar kompetencat e veta të parapara me ligj dhe si rezultat vendimin në vend të pa drejtë dhe jashtë ligjshëm sepse nuk janë respektuar rregullat e procedurës që janë me rëndësi për vendosjen e çështjes. Nëse kjo gjykatë konsideron se nuk është kompetentë për vendosje në këtë çështje dhe se kompetente është gjykata që vendos në konteste civile , atëherë lënda ti dërgohet gjykatës kompetente”.*

Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: *“Nga provat e administruara shifet se me ndërprerjen e punës së paditëses nuk është zbatuar Ligji i Punës, dhe e njëjta ka mbetur pa vend të punës edhe pse ka qenë ndër të parat punëtorë që ka filluar punën në K.K. Klllokot në vitin 2010, ka pasur shumë motra medicinale të pranuar më vonë, ndërsa sipas arsyetimit të K.K. Klllokot, paditëses dhe shumë punëtorëve të tjerë i është ndërprerë marrëdhënia e punës kinse për tepricë të punëtorëve, ndërsa menjëherë pas largimit të paditëse nga puna është hapur konkursi për vendin njëjtë të punës së paditëses, andaj nuk ka pasur nevojë të konsiderohet tepricë teknologjike. Gjykatës i propozoj të prish aktin administrativ dhe lëndën t’ia kthej të paditurës së parë në rivendosje ose nëse gjen arsye ligjore të aprovoi kërkesëpadinë paditëse, të anuloi vendimin e të paditurës së parë si jo ligjor. Shpenzimet e procedurës i kërkojmë për taksë gjyqësore shumë prej 50€, dhe për një seancë gjyqësore shumë prej 135 €, sipas TOAK-së”.*

I padituri i parë Inspektorati i Punës, me përgjigjen në padi të datës 28.09.2023 e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar duke pohuar se e paditura ka vepruar drejtë me vendimin e shkallës së parë dhe Inspektorati i punës posedon kompetencën e veprimit sipas Ligjit mbi inspektoratin e punës i cili i jep të drejtë që të mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të Ligjit të Punës,

andaj i propozon Gjykatës që të marr Aktgjykim me të cilin e refuzon në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar dhe mbetet në fuqi vendimi i të paditurës.

E paditura e dytë, me përgjigjen në padi të datës 19.10.2023 e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar duke kërkuar nga gjykata që këtë çështje ta vendos sipas ligjeve në fuqi, duke i propozuar gjykatës që të marr Aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit dhe mbetet në fuqi vendimi i të paditurës.

Me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike, gjykata ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendimi nr.297/2019 dt. 21.05.2019, kontrata për afat të caktuar e vërtetuar tek noteri A.. S.. me numër 3343/2019 dt.05.07.2019, vendimi i Komunës së Klllokotit 1467/2 dt.21.05.2018, vendimi i dt.19.06.2018, vendimi i I.P dt.28.12.2018, vendimi i I.P dt.05.04.2019 , vendimi i dt.04.04.2018, raporti zyrtar i I.P. dt.10.04.2019, fletë dorëzimi i dt. 04.04.2019.

Gjykata vendosi në mënyrë meritore në lidhje me vendimet e goditura me padi, dhe në përputhje me nenin 44, paragrafit 3 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor si dhe përgjigjeve në padi, gjeti se padia dhe kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Nga provat në shkresa të lëndës gjykata gjeti se organi i paditur kishte marrë aktvendimin e kontestuar me padi, përmes së cilit kishte refuzuar ankesës e palës në procedurë, përkatësisht paditësit dhe kishte vërtetuar vendimin e organit të shkallës së parë të Inspektoratit të Punës Nr.02/c-110 i datës 05.04.2019.

Gjykata fillimisht shqyrtoi aktin administrativ të goditur me padi në përputhje me nenin 35 Ligjit për Konfliktet Administrative, i cili përcakton: *“Nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë në bazë të paragrafit 2. të nenit 33, apo në bazë të nenit 34 të këtij ligji, kurse konstaton se akti administrativ i kontestuar përmban të meta esenciale, që e pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së aktit, e anulon me aktgjykim, aktin administrativ edhe pa e dërguar padinë në përgjigjen”.*

Po ashtu edhe në bazë të nenit 44, paragrafit 2 të të njëjtit ligj përcaktohet: *“Për nulitetin e aktit administrativ gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare”.*

Nga vendimi i kundërshtuar, gjykata vlerësoi se i njëjti përmban të meta esenciale që e pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së aktit. Kjo për faktin se sipas vlerësimit të gjykatës, e paditura ka vendosur jashtë kompetencave të saj ligjore të përcaktuara me ligj.

Për të vlerësuar këtë, gjykata iu referua nenit 2 të Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, i cili përcakton:

“2. Inspektorati i punës:

a) *Do të mbikëqyrë zbatimin e ligjit të punës, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë.*

b) *Do t’iu siguroj informacion teknik dhe këshilla punëdhënësve dhe punëtorëve për çështjet më të efektshme të zbatimit të dispozitave ligjore.*

c) Do të njoftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale apo ndonjë organ tjetër kompetent për ndonjë mungesë apo ndonjë shpërdorim në ligjin e aplikueshëm.

d) Do t'iu siguroj informatat dhe këshillat punëdhënësve dhe punëmarrësve të cilat do të jenë në pajtim me ligjin dhe t'i paralajmërojnë autoritetet kompetente për çfarëdo defektesh apo shpërdorimesh që nuk janë përfshirë me dispozita ligjore ekzistuese.

e) Do t'iu jep këshilla për çështje lidhur me ligjin e punës dhe mbrojtjen e punëtorëve me rastin e riorganizimit apo ristrukturimit të një ndërmarrjeje”.

Ndërsa me Ligjin Nr. 03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës nr. 2002/9, teksti te pika “a” e nenit 2, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë, zëvendësohet me tekstin “Ligjit për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, si dhe dispozitave tjera të aplikueshme nga fusha e punësimit dhe mbrojtjes në punë”.

Në anën tjetër, neni 79 i Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcakton: “Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të iniciojë kontest pune në Gjykatën Kompetente”.

Sipas Ligjit për Gjykatat, kompetente për shqyrtimin e lëndëve nga marrëdhënia e punës sipas dispozitës së lartcekur, janë gjykatat themelore në kontest civil, varësisht nga kompetenca territoriale.

Në bazë të nenit 4 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, organet publike duhet të veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. Ndërkaq paragrafi 2, 3 dhe 4 i këtij neni përcakton se:

“2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj;

3. Nëse ligji autorizon organin publik të ushtrojë pushtet diskrecionar në një vendimmarrje (në vijim “diskrecioni”), ai do të ushtrohet në mënyrë të ligjshme vetëm nëse plotësohen këto kushte:

3.1. nuk tejkalon kufijtë e përcaktuar në ligjin që lejon diskrecionin;

3.2. zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur qëllimin për të cilin ligji e parashikon diskrecionin dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Ligji, në veçanti me parimin e proporcionalitetit, dhe

3.3. zgjedhja e organit publik nuk është në kundërshtim me normat e gjithëpranuara të shkencës apo teknikës dhe nuk shkel parimet themelore të drejtësisë apo arsyes njerëzore.

4. Pushteti diskrecionar, përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, është mundësia që i jepet një organi publik, shprehimisht apo që nënkuptohet me ligj, për të vendosur duke zgjedhur në mes dy apo më shumë veprimeve të ligjshme, për t'i shërbyer në mënyrën sa më të përshtatshme interesit publik”.

Bazuar në këtë, gjykata vlerësoi se autoriteti i organeve administrative, në këtë rast i të paditurës Inspektorati i Punës, duhet të shtrihet deri në atë masë sa nuk tejkalon kufinj të kompetencës të cilat me ligj të veçantë janë përcaktuar tek një institucion tjetër, në këtë rast të gjykatës.

Neni 52 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcakton:

“1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:

1.1 është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji;

1.2 organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë;

1.3 është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;

1.4 është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ;

1.5 është në kundërshtim me ligjin material;

1.6 është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo

1.7 nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit”.

Gjykata konstatoi se në këtë rast e paditura e parë i ka tejkualuar kompetencat e veta të cilat i ka përcaktuar ligji, kompetencë kjo ekskluzive e gjykatës në kontest civil, dhe si rezultat, vendimin e bën të padrejtë dhe të paligjshëm, për shkak se nuk janë respektuar rregullat e procedurës që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes.

Në këtë mënyrë, gjykata erdhi në përfundim të qartë se vendimi është i kundërligjshëm si për nga forma ashtu edhe për nga përmbajtja dhe se i njëjti është i përfshirë në zbatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të ligjit material në rastin konkret.

Mbi këtë gjendje të fakteve, gjykata konstatoi se në këtë çështje administrative-juridike në çdo fazë të procedurës administrative të zhvilluara në të dy organet, është shkelur ligji në dëm të paditëses, dhe organet e paditura kanë dështuar të marrin Vendime të drejta e të bazuara në Ligj në lidhje me ankesën e paditëses dhe duke vendosur në kundërshtim me kompetencat e veta të përcaktuara me Ligj.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet tjera të të paditurave por për të njëjtat konsideroi se janë të pabazuara dhe pa ndikim në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike të këtij Konflikti administrativ.

Në lidhje me vendimin për shpenzimet procedurale, u vendos konform nenit 64 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Në bazë të asaj që u tha më lartë e në kuptim të nenit 5, 6, 38, 43, paragrafit 3, nenit 46, paragrafi 1, 2, 3, 4 dhe 5 si dhe nenit 68, paragrafit 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.1657/19, datë: 25.01.2024

Gj y q t a r i

Kreshnik Kaçi

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.